



Operatori i Sistemit të Transmetimit

OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT

DREJTORIA E PROKURIMEVE

Nr. _____ prot.
më ____ . ____ .2020

Tiranë,

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Nga: Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.)

Adresa: Tiranë Kashar Yrshek, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 9

Kontakt: www.ost.al; e-mail: info@ost.al.

Për: **OE: - “ENCOAL” sh.p.k.,** me NIPT L51531003F

Adresa: Rruga “Teodor Keko”, Godinë në Zona Kadastrale
3866, pasuria Nr. 305/316+1-N8, Yzberisht, Kashar, Tiranë.

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur” - me mjete elektronike – Punë

Numri i referencës i procedurës: REF-47033-12-31-2019

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Ndërhyrje për rastet emergjente (Punimet primare dhe sekondare në nënstacionin 220 kV të Rrashbullit për instalimin dhe vendosjen në punë të çelësit dhe ndarësit tre fazor 220 kV në traktin e zbaralidhësit si dhe furnizimi i paisjeve që u dëmtuan nga tërmeti i datës 26.11.2019)”.

Kohëzgjatja e kontratës: 5 (pesë) muaj nga hyrja në fuqi e kontratës.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike, Datë 13.01.2020, Nr. 01.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët.

Fondi Limit: 39,500,000 (tridhjetë e nëntë milion e pesëqind mijë) Lekë pa TVSH, nga të ardhurat e OST sh.a.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: Datë 10.02.2020.

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë 3 (tre) ofertues, me vlerë përkatëse të ofruar:

1. OE “ENCOAL” shpk me NIPT L51531003F
Me ofertë ekonomike 36,950,000 (tridhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH.
2. BOE “H&E Energy” sh.p.k. & “Everest” sh.p.k., me NIPT-et përkatëse

L71716029A & NIPT J78311921L

Me ofertë ekonomike 38,640,000 (tridhjetë e tetë milion e gjashtëqind e dyzet mijë) Lekë pa TVSH.

3. OE “ACI Engineering” sh.p.k. me NIPT L51609014F

Me ofertë ekonomike 39,263,880 (tridhjetë e nëntë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e tetëqind e tetëdhjetë) Lekë pa TVSH.

Janë s’kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. **BOE “H&E Energy” sh.p.k. & “Everest” sh.p.k.**, me NIPT-et përkatëse L71716029A & NIPT J78311921L, për arsye se:

- Nuk ka përmbushur **kriterin 2.3.1** të Kritereve të Vecanta të Kualifikimit, përse i përket pjesës së marrë përsipër nga OE “Everest” sh.p.k., si anëtar i BOE, pasi në kontratën e ngjashme që ka paraqitur, nuk është në përputhje me pjesën e marrë përsipër për realizimin e kontratës objekt procedure prokurimi.
- Nuk ka përmbushur **kriterin 2.3.4** të Kritereve të Vecanta të Kualifikimit, pasi në listën e inxhinierëve të paraqitur si punonjës të OE “Everest” sh.p.k., anëtar i BOE, inxhinierët mekanik dhe elektrik, nuk figurojnë në listpagesat për 12 muajt e fundit.
- Nuk ka përmbushur **kriterin 2.3.5** të Kritereve të Vecanta të Kualifikimit, pasi asnjë nga anëtarët e BOE, nuk kanë paraqitur dokumentacion për 1 (një) Inxhinier Elektrik i cili të jetë i trajnuar për mbrojtjen rele dhe Integrimin në sistemin SCADA të pajisjeve primare/secondare në N/Stacione elektrike si dhe të jetë njëri nga drejtuesit teknik të licencës së zbatimit të shoqërisë.
- Nuk ka përmbushur **kriterin 2.3.8** të Kritereve të Vecanta të Kualifikimit, pasi ka paraqitur vetëm një punonjës me kartelë sigurimi teknik të kategorisë V, të vlefshme. Kartelat e sigurimit teknik të paraqitura janë të pavlefshme, pasi afati i tyre ka mbaruar përpara datës së zhvillimit të tenderit.
- Nuk ka përmbushur **kriterin 2.3.13** të Kritereve të Vecanta të Kualifikimit, pasi në tabelën e paraqitur nga BOE ofertues, ka zëra që nuk janë të ofruara nga ofertuesi sipas të dhënave teknike të kërkuara.

2. **OE “ACI Engineering” sh.p.k.**, me NIPT L51609014F, për arsye se:

- Nuk ka përmbushur **kriterin 1/a** të kritereve të vecanta të kualifikimit, pasi në formularin e ofertës, Shtojca 1, ofertuesi ka deklaruar çmimin total te ofertes, vlerat 56,352,061.38 leke pa Tvsh dhe 67,622,473.66 lekë me Tvsh kurse ne tabelen e formularit te ofertes ka pershkruar vlerat 39,263,880 leke pa Tvsh dhe 47,116,656 lekë me Tvsh.
- Nuk ka përmbushur **kriterin 2.3.4** të kritereve të vecanta të kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për per te vertetuar se ka te punesuar te pakten 1 (nje) inxhinier mekanik dhe 1 (nje) inxhinier elektronik. Ka paraqitur dokumentacion dhe ka vertetuar se disponon 2 (dy) Inxhinier Elektrik.
- Nuk ka përmbushur **kriterin 2.3.5** të kritereve të vecanta të kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion dhe nuk ka vertetuar se ka te punesuar te pakten 1(nje) Inxhinier Elektrik i cili te jete i trajnuar per mbrojtjen rele dhe Integrimin ne

sistemin SCADA te pajisjeve primare/secondare ne N/Stacione elektrike.

- Nuk ka përmbushur **kriterin 2.3.7** të kriterëve të vecanta të kualifikimit, pasi ka paraqitur kartela të sigurimit teknik vetëm për 4 (katër) punonjës, ndërkohë që janë kërkuar që OE ofertues të ketë të paktën 10 (dhjetë) punonjës të pajisur me kartela sigurimi teknik për kategoritë IV-V.
- Nuk ka përmbushur **kriterin 2.3.8** të kriterëve të vecanta të kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion në lidhje me disponimin e 1 (një) manovratori të pajisur me kartelë personale të sigurimit teknik.
- Nuk ka përmbushur **kriterin 2.3.9** të kriterëve të vecanta të kualifikimit, pasi në dokumentacionin që ka paraqitur, nuk ka vertetuar se disponon Autovinc ≥ 16 Ton, ka me kontratë qiraje një kamion me vinç 15 Ton.
- Nuk ka përmbushur **kriterin 2.3.13** të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, pasi në tabelën e paraqitur nga OE ofertues disa të dhena teknike të paisjeve të ofertuara nuk janë në përputhje me kriteret teknike minimale të kerkuara, pikrisht: Per çelësin tre fazor 245 kV, Tensioni i lejuar ne 1 minute eshte kerkuar 530 kV rms eshte ofruar nga ofertuesi deri ne 460 kV rms si dhe ne lidhje me transformatoret e rymes 220 kV te paraqitur nuk ploteson parametrin e rrymave nominale te peshtjellave sekondare per mbrojtjen rele.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **OE “ENCOAL” sh.p.k. me NIPT L51531003F**, me adresë: Rruga “Teodor Keko”, Godinë në Zona Kadastrale 3866, pasuria Nr. 305/316+1-N8, Yzberisht, Kashar, Tiranë; se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **36,950,000 (tridhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH**, është identifikuar si ofertë e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Prokurimeve të OST sh.a., me adresë *Tiranë Kashar Yrshek, Autostrada Tiranë -Durrës, Km 9*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentet e tenderit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të procedohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 19.02.2020.

Ankesa: Jo.

ADMINISTRATOR I OST SH.A.

Skerdi Drenova